



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 11 mars 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA u njoh me kërkesën e depozituar nga z. Agron Gjekmarkaj për dorëheqje nga detyra e anëtarit të AMA-s, kërkesë, e cila do t'i bëhet me dije Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

AMA, në këtë mbledhje diskutoi:

- Mbi angazhimin e deritanishëm të Autoritetit të Mediave Audiovizive në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor.
- Raportin vjetor për veprimtarinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2020.

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e rregullores “Për kriteret dhe masat rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së”. (**Vendimi nr. 39, datë 11.03.2021**)
2. Miratimin e rregullores “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për shfrytëzimin e multipleksit”. (**Vendimi nr. 40, datë 11.03.2021**)
3. Pranimin e ankimit administrativ të shoqërisë “Selenicë Kabllor” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Selenicë” dhe shfuqizimin e vendimit nr. 2 datë 02.03.2021 për dënimin me gjobë. (**Vendimi nr. 41, datë 11.03.2021**)
4. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “TV Klan” sh.a., për caktimin e përkohshëm të Numrit Logjik të Programit për shërbimin programor tematik, pjesë e paketës së tij programore “Klan News”. (**Vendimi nr. 42, datë 11.03.2021**)

Disa nga çështjet e rendit të ditës, (aplikime për marrje/rinovim licence/autorizimi) vendimmarrja e të cilave kërkon kuorum të cilësuar, shtyhen në një kohë të dytë, me plotësimin e trupës kolegjiale.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 11.03.2021